VENDIM
Nr. 576, datë 18.9.2024

PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DYPALËSHE "*CORRIDOR VIII RESPONSE*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjë "b", të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët "*Corridor VIII Response",* në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.
2. Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 825 (tetëqind e njëzet e pesë) trupave ushtarakë të Britanisë së Madhe.
3. Qëllimi i pjesëmarrjes të Forcave të Armatosura është demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për koordinimin, sigurimin e teatrit të zbarkimit, pritjen dhe shoqërimin e forcave britanike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Stërvitja zhvillohet në periudhën 18 shtator–13 tetor 2024, në afërsi të Bazës Detare të Pashalimanit, sipas teknikave amfibe dhe në Portin e Durrësit për trupat e *Strategic Reserve Force* (SRF).
5. Trupat britanikë, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.
6. Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat britanikë shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama